

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.01.2023*

23.01.2023

Ora 12:55

**RENDI I DITËS**

**Projktvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.16, të subjektit ankues Partia Fryma e Re Demokratike, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.224, dt. 7.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve””.**


**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.  
**Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaç, Z. Erdal Mema, Znj. Kejsa Bici.  
**Të tjerë:** Z. Alfred Feto (FRD), KRIIK

**Z. E. Lako:** Atëherë deklarojmë të çelur seancën e sotme “Për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr.16, të subjektit ankues Partia Fryma e Re Demokratike, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.224, dt. 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e raportit të zgjedhjeve nga auditimi i fondeve të audituara, të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, pjesëmarrëse në Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021””. Sipas shortit të hedhur, relator i kësaj çështjeje jam unë Elvin Lako. Para se të filloj me shqyrtimin e çështjes verifikojmë aspektin procedural të palëve në proces. Subjekti ankues edhe njëherë të lutem me mikrofon.

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Përfaqësues i Partisë Fryma e Re Demokratike. Emri im është Alfred Feto.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.01.2023*

**Z. E. Lako:** Ndonjë kërkesë për ndonjë palë të interesuar nuk kemi. Atëherë vazhdojmë me procesin. Të pranishëm janë anëtarët e KAS-it, është përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretar i Përgjithshëm dhe stafi, administrata. I bëj pyetje palës nëse ka ndonjë kërkesë paraprake për përjashtim të ndonjë anëtari të KAS-it apo legjitimitetin e KAS-it. Ke ndonjë kërkesë paraprake?

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Jo nuk kam.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, vazhdojmë me shqyrtimin në themel të çështjes. Zoti Sekretar i Përgjithshëm ju lutem shkurtimisht disa fjalë në lidhje me objektin e ankimit dhe pretendimet e palës.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 224, dt. 07.12.2022 ka miratuar raportin e gjetjeve nga audituesit për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Në pikën 21 të këtij vendimi Komisioneri ka vendosur detyrimin e Partisë Politike Fryma e Re Demokratike të kthejë në KQZ shumën prej 485.332 (Katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekësh, sipas nenit 88, pika 7 e Kodit Zgjedhor. Kundër këtij vendimi, duke mos qenë dakord, ka bërë ankim subjekti ankues Partia Fryma e Re Demokratike, duke pretenduar se kjo diferencë është paguar dhe është shpenzuar nga Partia Fryma e Re demokratike, jo në këtë periudhë zgjedhore por në vazhdimësi, jashtë kësaj periudhe zgjedhore, kështu që duhet të thotë në vendim se nuk jemi në rastin e pikës 7, të nenit 88 të Kodit Zgjedhor. Vendimi i Komisionerit është marrë në bazë të nenit 88, pika 7, të Kodit Zgjedhor, pasi në zbatim të këtij neni si dhe të vendimit nr. 172, dt. 23.03.2021 Komisioni ka përcaktuar partitë

**Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.01.2023*

politike përfituese të fondeve nga buxheti i shtetit si dhe vlerën paguese për secilën parti. Nga fondet e shpërndara si paradhënie për fushatën zgjedhore kanë përfituar 10 parti politike, në të cilat është dhe Partia Fryma e Re Demokratike, e cila ka marrë si paradhënie shumën prej 2.188.832 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë. Nga verifikimet e kryera konstatohet se është shpenzuar 1.703.500 (një milion e shtatëqind e tre mijë e pesëqind) lekë. Diferenca ngelet 485.332, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm! I jap fjalën palës ankuese.

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

**Z. E. Lako:** Do të parashtrosh njëherë argumentat që ke dhe pastaj patjetër nëqoftëse keni pyetje... Kështu që ju lutem vazhdoni me parashtrimin e çështjeve që keni ngritur në ankim dhe çfarë provash keni.

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Faleminderit! Pas sqarimit shumë korrekt, ne jemi dakord me atë çfarë u tha. Në bazë të nenit 86, pika b “Për financimin e partive politike nga buxheti i shtetit” edhe Fryma Re Demokratike mori një shifër që u përmend, për fushatën elektorale të vitit 2021. E përmenda dhe javën e kaluar, megjithëse ju kërkoj ndjesë sepse unë nuk kam qenë këtu, kam qenë jashtë dhe nuk kam qenë shumë i përgatitur. Historikisht do të thoja që në fushatën elektorale janë regjistruar parti fantazma, nuk do të zgjatëm shumë, me kryetar partish, kanë marrë fondet, nuk është kërkuar llogari dhe ne nuk jemi për këtë rast. Shumë mirë që shteti forcohet, hallkat forcohen dhe kërkohet llogari. Rasti konkret, sic u theksua fondet janë përdorur në mënyrë tepër korrekte dhe unë pak më parë doja të bëja një


*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.01.2023*

pyetje që, ka patur ankimime të tjera për Frymen e Re Demokratike për sa i përket financave, për sa i përket “lojes elektorale” që ka zhvilluar kjo parti? Besoj se jo, sepse aty ka njerëz që e vlerësojnë profesionin edhe ndershmërinë. Për ta ilustruar këtë, në zgjedhjet e vitit 2017 Partia Fryma e Re Demokratike ka kthyer rreth 17.000.000 (shtatëmbëdhjetë milion) lekë të vjetër pas atyre zgjedhjeve. Kjo tregon se ne kemi qenë korrekt. Tani në rastin konkret, është e vertetë se këto financa, këto para janë lixhluar edhe fill pas fushatës elektorale. Qëllimi i aktiviteteve politike në Shqipëri, qëllimi i surrealizmit nuk është që të jetojnë dy parti, por duhet të ketë më shumë se dy parti. Do të thoja se këto parti kanë patur shumë vështirësi dhe e përmenda tangent që një ndër elementët kryesorë të zhvillimit të një fushate elektorale është edhe financimi. Pa ato nuk mund të bësh dot fushatë. Jam i detyruar ta përmend pa i hyrë në analizë. Të gjithë ne kemi parë të paktën në televizione ato skenat jo të dëshëruara kur Partia Fryma e Re Demokratike nxirrej me dhunë nga selia e vet. Nuk them se cila palë ka patur të drejtë, duke marrë pjesë dhe presidenca, por në aspektin vizual ishte një shfaqje shumë e shëmtuar. Kujtoj që partitë politike janë asete shtetërore dhe në çdo vend nëse largohet një subjekt, qoftë me të drejtë, qoftë më të padrejtë nga selia, duhet ti sigurohet një seli tjetër, gjë që nuk ndodh. Nëse largohet një qytetar nga shtëpia e vet, duhet ti sigurohet një strehë, janë ligje ndërkombëtare. Në rastin konkret mua më ka rastisur shumë si të gjithë shqiptarët që ndodhen në Gjermani. Gjermanët janë një komb që e respektojnë ligjin dhe shtetin gjerman, por ata kanë një thënie, “nuk ka rregull pa përjashtim”. Këto para janë shfrytëzuar për mbijetesë jo për korrupsion, sepse fill pas asaj nxjerrje jashtë nga selia, ne kemi një kontratë këtu, një kontratë ligjore e lidhur me zotin Arben Kasmi. Përballë Parlamentit është selia dhe është 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë të reja, plus edhe shpenzime shtesë që nuk do i përmend, dihen ato. Këtu kam një shkresë për pasqyrat financiare për vitin

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.01.2023*

2021. Nga eksperiencia e viteve të kaluara praktika ka qenë kështu. Tre muaj bëhej auditimi dhe mbas auditimit Komisioneri Shtetëror ose Komisioni Qendror i Zgjedhjeve caktonte detyrimet që kishin partitë politike . Siç e përmenda pak më lart që ne i kthyem në vitin 2017. Në rastin konkret nuk po them nga prilli i vitit 2021 por të themi nga shtatori i vitit 2021 nuk ka ardhur detyrimi që duhet të kenë partitë politike, por kanë ardhur tani, siç e përmendi zotëria i respektuar. Numri i vendimit 224, dt. 07.12.2022. Ka kaluar një afat shumë i gjatë. Këto para pastaj është detyra juaj që të gjykoni, janë shfrytëzuar për këto shpenzime. Po të llogarisim kohën që FRD-ja ka mbijetuar, kështu do e quaja unë, këto justifikohen. Kaq kisha, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Në lidhje me pyetjen ose sqarimin që kërkoi nga administrata që ky subjekt ka patur raste të tjera të shkeljeve të konstatuara, keni ndonjë koment zoti Ylli?

**Z. Y. Merkaçaj:** Jo nuk ka patur raste të tjera shkeljesh dhe në vendimin e Komisionerit nuk është përcaktuar masë administrative, kështu që nuk ka patur.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Atëherë kam unë disa pyetje shumë shkurtimisht, sepse pak a shumë ishit të qartë në shpjegimet tuaja. Në lidhje me pikën 21 të vendimit të Komisionerit, pra për detyrimin e kësaj shumës prej 485.332 (Katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekësh. Ju nuk keni kundërshtim në përcaktimin e kësaj vlere, pra nga llogaritja që ka bërë Komisioneri, nuk është se keni ndonjë shifër tjetër, si shifër kjo qëndron apo jo.

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Po e thashë që në fillim, jemi dakord.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.01.2023*

**Z. E. Lako:** Sqarimi i dytë është që ju pretendoni se një pjesë të shumës që duhet të kthehet ju e keni shpenzuar mbas fushatës dhe periudhës tjetër përsa i përket pagesës së qërasë për zyrën, për shkak se nuk keni patur zyre. Kjo është pak a shumë ajo që sqaruat. Kjo është në një vlerë prej 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekësh, se nuk përcaktuat një vlerë të plotë apo jo?

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

**Z. E. Lako:** Atëherë ato që keni dorëzujini ju lutem për të ditur se sa është vlera që ju keni shpenzuar për periudhën. Unë nuk kam më pyetje. Nëse kolegët kanë ndonjë pyetje për administratën apo... Keni ndonjë pyetje? Po zoti Çefa.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Një pyetje për ankuesin. Këtë dokumentin kontratë qëraje që sapo e administruat si provë a ja keni paraqitur ekspertit kontabël të caktuar nga KQZ-ja në momentin kur ai po bënte auditimin e shpenzimit të fondeve të dhëna për fushatë?

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Pyetja është logjike dhe faleminderit. Për të qenë korrekt nuk e di këtë, por kjo ka datën kur është bërë kontrata dhe lehtësisht mund të llogaritet.

**Z. Y. Merkaj:** Në datën 1 qershor 2022 është lidhur kontrata e qërasë.

**Z. E. Lako:** Atëherë nëse nuk ka më pyetje, ftojme palët shkurtimisht, çfarë kërkoni nga KAS-i. Pala ankuese fillimisht.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.01.2023*

**Z. A. Feto, përfaqësues i FRD-së:** Ne jemi shprehur me shkrim, që të anulohet kjo...

**Z. E. Lako:** Shfuqizimin e kësaj pikës, ndërsa ju zoti Ylli?

**Z. Y. Merkaj:** Ne jemi pjesë e administratës që përfaqësojmë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, kështu që jemi për lënien në fuqi të vendimit dhe kërkesës...

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim. Për 10 minuta ju ftojme edhe njëherë që të dëgjoni vendimin.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora 13:24**

**Z. E. Lako:** Atëherë, pasi dëgjuam dhe morëm parasysh pretendimet e palëve , mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja b, të ligjit 10.019, dt. 29.12.2008 ..... i ndryshuar dhe provat e dokumentuara, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 16, subjekt ankues Partia Fryma e Re Demokratike .
2. Lënien në fuqi të pikës 21 të vendimit të Komisionerit nr 224, dt. 07.12.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Seanca mbyllet, ju faleminderit!

**Vendimi nr. 6**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

